



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:223456

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05566082

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.. K.. për shkak të veprës penale Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit nga neni 338 par 3 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.2191/23 të datës 24.11.2023, pas mbajtës së seancës se shqyrtimit fillestar të hapur për publikun me datë 25.03.2024 në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit A.. K.. dhe mbrojtësi i tij av. Budak Shala sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datë 12.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.. K.., i lindur më datë në K. P..., me vendbanim në fshatin P..., K-P..., i biri i S.. dhe nënës A.. e vajzërisë H., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion teknik i makinerisë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., posedues i numrit të telefonit, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Më datë 15.192023 rreth orës 18:10 në fshatin P..., K-P..., pikërisht në Rr “K.. S...”, me dashje e me qëllim të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të tokës, në atë mënyrë që, ditën kritike gjate

patrullimeve në lokacionin e lartcekur, policia ndalon të pandehurin i cili ishte duke drejtuar kamionin e tipit M.. me targa-DM, i njëjti kamionin e kishte të ngarkuar me zhavorr të tipit Fraksion 3, të cilën ngarkesë e kishte marrë ilegalisht në seperacionin e tij, të cilin e posedon pa asnjë dokument përkatës për ushtrimin e kësaj veprimtarie,

- me çka ka kryer vepër penale Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit nga neni 338 par 3 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 7, 17, 38, 39, 46, 47, 49, 69, 70, 71, 72, 338 par 3 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK- së, të pandehurit A.. K.. i shqipton:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Dënim me gjobë në shumë prej 800,00 € (tetëqind) euro, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të pandehurit i kthehen sendet e sekuestruara përkohësisht dhe atë: lug ngarkuese “L..” ..., B.. V.. E.. 2..., Ç.. të bagerit V.. E... dhe pajisje seperimi, menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 24.11.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2191/23 ndaj të akuzuarit A.. K.. për shkak të veprës penale Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit nga neni 338 par 3 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 25.03.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike

nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë. I pandehuri është deklaruar e pranoj fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, duke shtuar se: e pranoj fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Budak Shala ka deklaruar: pajtohem me pranim e fajësisë nga ana e te mbrojturit tim , konsideroj se e njëjta ka ardhë në përputhje me dispozitat e KPRPK-së, është e vërtetë që i njëjti ka në pronësi mjetet e përshkruara dhe ashtu siç është konstatuar në provat e rastit i njëjti merret me trajtimin dhe grumbullimin e mjeteve inerte dhe me seperimin e mineraleve që shumicën prej tyre i ka blere dhe të njëjtat i trajton në hapësirën që e ka në posedim dhe ne bazë të porosive e transporton, kërkoj nga gjykata se gjatë matjes se lartësisë se dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësues dhe atë pranimi i fajësisë sa i përket këtij veprimi që ne fazën fillestare pran policisë, e kaluara e tije si dhe premtimi i të njëjtit se edhe për kundër që i ka këto pajisje nuk do të veproi në as një aktivitet deri sa të pajiset me licenca përkatëse, i propozoi gjykatës që sendet e konfiskuara në procedure paraprake të kthehen të pandehurit, edhe pse të njëjtat ligjërisht nuk janë konfiskuar nga se në procedure paraprake gjykata e ka hudh kërkesën e prokurorisë për konfiskim, ndërsa gjykata e Apelit të njëjtin rast e ka kthyer në rivendosje përkatësisht kërkesën për urdhër përfundimtarë.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarin A.. K., e datës 15.10.2023, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, e datës 16.10.2023; Raporti i Këqyrjes së vendit të ngjarjes, e datës 15.10.2023; Raporti nga Hetuesi N.. E.. #....., i datës 18.10.2023; Raporti nga Hetuesi N.. E.. #..., i datës 18.10.2023; Raporti nga Hetuesi N.. E.. #..., i datës 18.10.2023; Raporti i Inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit nga MMPHI, e datës 16.08.2023; Procesverbal mbi inspektimin e kryer, me nr.01377; Raportimi i veprës penale nga Komisioni për Minierës dhe Minerale, e datës 18.20.2023; Urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar, me nr.000216; Raporti i

operimit të Jashtëligjshëm minerar-Seperacionin, i datës 17.10.2023, Urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar, me nr.000213, Raporti mbi kalkulimin e vëllimit, i datës 18.10.2023, Raporti për operim Ilegal-Departamenti i Financave, i datës 18.10.2023, Raport nga departamenti i Inspektoratit me nr. 13-352, i datës 17.10.2023, Certifikata e njësisë kadastrale, e datës 16.10.2023, Fotoalbumi: 46 fotografi në 24 fletë të formatit A4; andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 338 par.3 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjen në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i tërhequr e vërejtjen me kërcënimin e dënimit me burgim dhe dënimit me gjobë, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Gjykata ka vlerësuar kërkesën e mbrojtjes për kthimin e sendeve të konfiskuara në procedurë parapake menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ngase në rastin konkret gjykata ka gjetur se nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të këtij sendeve dhe atë; lug ngarkuese

“L,,,” 9., B.. V.. Ec 2., Ç.. të b.. V.. EL2.. dhe pajisje seperimi, ngase për te njëjta ne procedurë paraprake është zhvilluar procedura si ne vijim:

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e procedurës paraprake, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datën 24.10.2023 me parashtrësën nën shenjen UGJK.nr. 128/23, kërkesën e sipërshtënuar e ka kthyer në plotësim në kuptim të nenit 441 par.3 dhe 4 e lidhur me nenin 261 të KPPRK-së, ku vërejtjet e dhëna në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore janë përshkruar më detajisht si në atë parashtrësë.

Me dt. 25.10.2023 gjykata ka pranuar nga Prokuroria Themelore në Pejë një akt përcjellës nën shenjen PPN/II Nr. 732/23, ku bashkangjitur me të njëjtin janë dorëzuar provat të cilat për momentin i ka në dispozicion Prokuroria Themelore në Pejë lidhur me këtë rast, dhe atë urdhër i përkohshëm i ndalimit të dt.17.10.2023 dhe kërkesa për sekuestrimin e pasurisë të dt. 16.10.2023.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me dt. 02.11.2023 ka nxjerr Aktvendim nën shenjen UGJK.nr.128/23 me të cilin kërkesa për lëshimin e urdhrin ndalues përfundimtar është hedhur si e parregullt ligjërisht.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin nën shenjen PN.nr.1437/23, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës së shkalles së pare të dt. 02.11.2023 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje të njëjtës Gjykatë.

Ne rivendosje Gjykata ne Procedurë paraprake me aktvendim të datës UGJK.nr. 128/23 të datës 15.03.2024 (2023:223456) ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PPN/II Nr. 732/23 dt. 19.10.2023 për lëshimin e urdhrin ndalues përfundimtar, në çështjen penale ndaj të dyshuarit A.. K., për shkak të dyshimit së kishte për të kryer veprën penale “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit” nga neni 338 të KPRK-së, SI E PABAZUAR, ndërsa ne pikën II ka ***Urdhëruar kthimi i sendeve të sekuestruara me urdhrin e përkohshëm të ndalimit nën shenjen PPN/II Nr. 732/23 dt. 17.10.2023 të pandehurit A.. K., pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.***

Prandaj gjykata ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktvendim duke kthyer sendet të pandehurit meqenëse në procedurë paraprake me aktvendimin UGJK.nr.128/23 të datës 15.03.2024 është Urdhëruar kthimi i sendeve të sekuestruara me urdhrin e përkohshëm të ndalimit nën shenjen PPN/II Nr. 732/23 dt. 17.10.2023 të pandehurit A.. K., pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e meqenëse të njëjtat sende nuk janë të përfituara me

kryerjen e veprës penale, dhe ne rastin konkret nuk ekzistojnë bazat për konfiskim nga neni 276 i KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:223456, 12.04.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate